19264

**REPUBLIK E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**
**NR REGJ.**

# VENDIM
## MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me daten 17.04.1998, une Orula Cofo gjyqtare ne Gjykaten e Rrethit Tirane, pasi pashe kerkesen dhe materiale t e kerkuesve Qatip Sufa dhe Bezat Sufa qe ben fjale per regjistrimin si person juridik te shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ne emrin "Sufa" SHPK,

## KONSTATOVA:

Se kerkuesit Qatip Sufa dhe Bezat Sufa kane bere kerkese per te bere regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin "SUFA" SHPK per te ushtruar veprimtari private ne fushen e : Perpunim dhe tregtim te rrenjes se shqopes dhe marese, si dhe mbareshtimine pyjeve , pyllezime, permiresime pyjore , sistemime malore, shfrytezimin e pyjeve , rruget pyjore , mbareshtimin e flores spontane mjekesore e tanifere , mbareshtimin e faunes dhe gjuetine sportive e turistike , mbrojtjen nga semundjet , demtuesit dhe zjarret , mbareshtimin e kullotave dhe livadheve , ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe, tregtimin me shumice dhe me pakice I mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, fruta perime, pajisje elektrike ,elektroshtepiake, mallra te te gjitha llojeve, materiale dhe pajisje te ketyre mallrave industriale, prodhimi dhe tregtimi I pjeseve te tyre te kembimit,etj., eksport importin e te gjitha mallrave e materialeve .

.Kapitali themelor I shoqerise do te jete ne shume 100.000 leke, selia e saj do te jete ne Damjan , Vaqar rrethit Tiranes, Administrator I saj do te jete Qatip Sufa, kohezgjatjae shoqerise do te jete mbi 10 vjet, ortaket Qatip Sufa e Bezat Sufa.

Nga shqyrtimi I materialeve rezulton se kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar,

## PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit 7667 date 28.01.1993,

## VENDOSA :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin "SUFA" shpk, me ortake Qatip Sufa dhe Bezat Sufa, per te ushtruar veprimtarine private ne fushen e : Perpunim dhe tregtim te rrenjes se shqopes dhe marese, si dhe mbareshtimine pyjeve , pyllezime, permiresime pyjore , sistemime malore, shfrytezimin e pyjeve , rruget pyjore , mbareshtimin e flores spontane mjekesore e tanifere , mbareshtimin e faunes dhe gjuetine sportive e turistike , mbrojtjen nga semundjet , demtuesit dhe zjarret , mbareshtimin e kullotave dhe livadheve , ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe, tregtimin me shumice dhe me pakice I mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, fruta perime, pajisje elektrike ,elektroshtepiake, mallra te te gjitha llojeve, materiale dhe pajisje te ketyre mallrave industriale, prodhimi dhe tregtimi I pjeseve te tyre te kembimit,etj., eksport importin e te gjitha mallrave e materialeve .

Kapitali themelor I shoqerise do te jete 100.000 leke.
Selia e shoqerise do te jete ne Damjan Vaqar rrethit Tirane .
Kohezgjatja mbi 10 vjet .
Administrator I shoqerise do te jete Qatip Sufa.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim .

**GJYQTARE**

Orula Cofo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR....18264/1....PROT

# VENDIM
## I GJYQTARES VETME

Sot me dt....18...9....2002 une gjyqtare e Gjykates se shkalles pare Tirane ...................pasi shqyrtova dekumentat e paraqitura nga Z.Qatip Sufa per depozitimin e vendimit nr. 1 , dt. 16.09.2002

## KONSTATOVA

Me vendimin nr. 19264 dt. 17.04.1998 eshte rregjistruar shoqeria **"SUFA"**sh.p.k. me Ortak Z.Qatip Sufa dhe Z.Bezat Sufa .Objekti I veprimtarise se Shoqerise eshte:
Perpunim dhe tregetim te rrenjes se shqopes dhe marese , si dhe mbareshtimin e pyjeve, pyllezime , permiresime pyjore , sistemime malore , shfrytezimin e pyjeve , rruget pyjore , mbareshtrimin e kullotave dhe livadheve , ndertimin dhe merementimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe , tregetimin me shumice dhe me pakice i mallrave te ndryshme ushqimore , industriale , fruta perime , pajisje elektrike , elektroshtepiake, mallra te te gjitha llojeve, materiale dhe pajisje te ketyre mallrave industriale , prodhimi dhe treghetimi I pjeseve te tyre te kembimit , etj.,eksport emportin e te gjitha mallrave e materialeve.

Me vendimin nr.1 dt.16.09.2002 asambleja e ortakeve ka vendosur te shtoje objektin e veprimtarise ne:
Prodhim e tregetim llullash , import-eksport.
Tregetim materiale ndertimi , prodhim e tregetim qymyr druri si dhe artikuj artistik rte te gjitha llojeve me materiale druri e qeramike.
Tregetim karburantesh e vajra lubrifikante me pakice.
- Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

## PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 neni 24 dhe 71 si dhe te ligjit nr.7667 dt.28.01.1993

## V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses.
-Depozitimin e vendimit nr.1 dt.16.09.2002 me te cilin shtohet objekti I veprimtarise ne :
Prodhim e tregetim llullash , import-eksport.
Tregetim materiale ndertimi , prodhim e tregetim qymyr druri si dhe artikuj artistik rte te gjitha llojeve me materiale druri e qeramike.
Tregetim karburantesh e vajra lubrifikante me pakice.

- Urdherohet Zyra e rregjistrit tregetar te beje ndryshime perkatese.
Ndarjen e kollonave me vize te kuqe.

GJYQTARE

Gilmle Bod

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**NR. 19264/2 VENDIMI**

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 19/7/ 2005, une, R. Pauyok gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit date 28.06.2005 te Asambese se ortakeve te Shoqerise "SUFA " sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

## K O N S T A T O V A :

Me vendimin nr. 19264 , dt.17.04.1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "SUFA " sh.p.k Me vendimin dt 28.06.2005 te Asamblese te ortakeve te shoqerise " SUFA " sh p k eshte vendosur :

1-Miratimin e llogarive vjetore sipas dokumentacionit te paraqitur si Bilanc Kontabel te ushtrimit 2004 se bashku me pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve.

2-Fitimet e realizuara nga shoqeria per vitin ushtrimor te mos shperndahen ne forme dividenti por te kalojne ne shtese kapitali , te kapitalizohen.

3-Miratimin e znj. Leze Abazi si eksperte kontabel e autorizuar me license nr 24 date 11.01.2000 per hartimin e raportit per shtesen e kapitalit nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri ne 31.12.2004 sipas dokumentacionit qe disponon ajo.

-Ne keto kushte kerkoj depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar .

Kerkesa eshte e drejte e duhet pranuar.

:.

## PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

## VENDOSA

-Pranimin e kerkeses.
-Depozitimin prane Zyres se Rregjistrit tregtar te vendimit date 28.06.2005 te Asamblese te ortakeve te shoqerise " SUFA " sh p k .
-Urdherohet Zyra e Rregjistrit tregtar te beje shenimet ne kolonat perkatese.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR. 19264/3/VENDIMI

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 24/10/ 2005, une, R. Laufaj gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit date 22.07.2005 te Asambese se ortakeve te Shoqerise "SUFA " sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

## K O N S T A T O V A :

-Me vendimin nr. 19264 , dt.17.04.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare " SUFA " sh.p.k.

Kane filluar procedurat mbi zmadhimin e kapitalit te shoqerise duke u caktuar eksperte kontabel znj. Leze Abazi.

-Me vendimin date 22.07.2005 Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka vendosur :

1-Miratimin per zmadhimin e kapitalit prej 7.448.000 leke , pra nga 100.000 leke qe ishte te behet prej 7.548.000 leke nga fitimet e realizuara e rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004 sipas raportit te ekspertit kontabel.

2-Kapitali zoterohet nga ortaket sipas perqindjeve te pjesmarrjes :
1-Z. Qatip Sufa me pjesmarrje 50 % ose 3.774.000 leke .
2-z Bezat Sufa me pjesmarrje 50 % ose 3.774.000 leke

3.Gjithe dokumentacioni i pregatitur per zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet deri ne 31.12.2004 te shoqerise " Sufa" sh p k te depozitohet ne rregjistrin tregtar sipas kerkesave te ligjit " Mbi shoqerite tregtare" dhe statutit te shoqerise .

Ne keto kushte kerkesa eshte e drejte e duhet pranuar

## PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

## VENDOSA

-Pranimin e kerkeses.

-Depozitimin prane Zyres se Rregjistrit tregtar te raportit te vleresimt te zmadhimit te kapitalit te shoqerise te dates 22.07.2005 , bilancit bashkangjitur raportit te vleresimit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise , vendimit date 22.07.2005 te Asamblese te ortakeve te shoqerise " SUFA " sh p k me te cilin eshte vendosur rritja e kapitalit te shoqerise ne vleren 7.548.000 leke.

-Urdherohet Zyra e Rregjistrit tregtar te beje shenimet ne kolonat perkatese.

GJYQTARE

Regleta Plqnojeh

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**Nr....19264/4........**

# VENDIM
## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten 27.06/2006, Une Ariona Grembarolli (Caco) Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mbasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentet e paraqitura nga kerkuesi Qatip Sufa administrator i te shoqerise "SUFA" sh.p.k.

## KONSTATOVA

Shoqeria "SUFA" SH.P.K eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 19264, date 17.04.1998, te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, me ortake themelues z. Bezat Sufa dhe Qatip Sufa, me kapital themeltar 100.000 leke, kontribut i ortakeve themelues ne masen 50% secili, me seli ne Tirane, me afat veprimtarie mbi 10 vjet, me administrator te shoqerise z. Qatip Sufa dhe objekt veprimtarie sipas statutit dhe aktit te themelimit.

Asambleja e ortakeve me vendimin nr. 2 date 17.05.2006 ka vendosur:

Pranimin si ortake te rinj ne shoqeri te z. Sabit Sufa, z. Ajet Sufa, z. Lulzim Sufa, z. Izet Sufa dhe kalimin ne favor te ortakeve te rinj nga 15% sejcilit te kuotave te kapitalit themeltar me ane te kontrates se shitjes se kuotave. Shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise dhe per aktivitetin: "Ndertim-Montim dhe operator te prodhimit te energjise elektrike, te venjes ne perdorim te hidrocentraleve te rinj te kapaciteteve te vegjel e te mesem. Transformimin dhe shperndarjen e energjise elektrike".

Nga sa me siper kerkesa eshte e drejte, e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARESYE
## NE BAZE TE LIGJIT nr.7667, DT. 28/01/1993 DHE LIGJIT NR. 7638, DT.19/11/1992
## VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve nr 2 date 17.05.2006 per pranim ortakesh te rinj dhe kalimin ne favor te tyre nga 15% sejcilit te kuotave te kapitalit themeltar me ane te kontrates se shitjes se kuotave. Shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise dhe per aktivitetin: "Ndertim-Montim dhe operator te prodhimit te energjise elektrike, te venjes ne perdorim te hidrocentraleve te rinj te kapaciteteve te vegjel e te mesem. Transformimin dhe shperndarjen e energjise elektrike".
- Depozitimin e kontratese se shitjes se kuotave te kapitalit themeltar.

- Perfundimisht shoqeria do te zoterohet nga ortaket z. Qatip Sufa z. Bezat Sufa te cilet zoterojne sejcili nga 20% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, z. Sabit Sufa, z. Ajet Sufa, z. Lulzim Sufa, z. Izet Sufa te cilet zoterojne sejcili nga 15% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Administrator i shoqerise do te jete z. Qatip Sufa.
- Te behen ndryshimet perkatese ne regjistrin tregtar ne kolonen perkatese.

**GJYQTARE**

Ariana Gamberolli

(caco)

# Shënim regjistrimi

- Emri "Sufa" sh.p.k. - 15264

- Kapitali 100.000 lekë

- Kohëzgjatja mbi 100 vjet

- Me objekt: Përpunimi dhe tregtimi të mallrave të shpejtë etj

- Me ortak Qatip Sufa dhe Bejat Sufa, me administrator Qatip Sufa.

- Me seli Damjan, Vepor Tiranë

Statuti 4 fletë

akt themelimi 2 fletë

data e dorëzimit 17.04.03
data e regjistrimit 17.04.03

Gjyqtari

# K O N T R A T E
# PER THEMELIMIN E SHOQERISE "SUFA" SHPK

E lidhur ndermjet paleve:

1. **QATIP SUFA** , I biri I Mexhitit, I dtl. 1954, me banim ne Damjan Vaqar, me shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.
2. **BE[redacted] SUFA** , I biri I Mexhitit, I dtl. 1963, me banim ne Damjan Vaqar, me shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar

Te dy palet duke qene te pranishem, te deklaruar ortake rane dakort qe kontraten e themelimit te shoqerise e se perbashket ta formulojne sipas kerkesave te ligjit 7638 date 19.111992 "Per shoqerite Tregtare " si dhe ne baze te ligjit 7667 date 28.1.1993. " Per regjistrin Tregtar" , vendosen sa me poshte:

**NENI 1**

Te krijojne shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar SHPK, e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate, me statutin e perbashket dhe ligjin 7871, date 09/11/1994, neni 7.

Kjo shoqeri do te emertohet "SUFA" SHPK.

**NENI 2**

Shoqeria "Sufa" Shpk do te kete seline ne Damjan Vaqar, rrethit Tirane, dhe do te ushtroje veprimtari per nje periudhe kohe mbi 10 vjet, me te drejte perseritjeje per periudhen e metejshme neqoftese bien dakort ortaket unanimisht, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

**NENI 3**

Shoqeria "Sufa" Shpk do te kete per objekt te veprimtarise se saj : Perpunim dhe tregtim te rrenjes se shqopes dhe marese, si dhe mbareshtimine pyjeve , pyllezime, permiresime pyjore , sistemime malore, shfrytezimin e pyjeve , rruget pyjore , mbareshtimin e flores spontane mjekesore e tanifere , mbareshtimin e faunes dhe gjuetine sportive e turistike , mbrojtjen nga semundjet , demtuesit dhe zjarret , mbareshtimin e kullotave dhe livadheve , ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe, tregtimin me shumice dhe me pakice I mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, fruta perime, pajisje elektrike ,elektroshtepiake, mallra te te gjitha llojeve, materiale dhe pajisje te ketyre mallrave industriale, prodhimi dhe tregtimi I pjeseve te tyre te kembimit,etj., eksport importin e te gjitha mallrave e materialeve .

**NENI 4**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin , vendqendrimin dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marrin me miratim te perbashket te dy ortaket.

**NENI 5**

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortaket rane dakort te bashkojne kapitqlet e tyre per persosjen e organizimit e zhvillimin e veprimtarise se saj. Kapitali themeeltar I shoqerise do te jete 100.000 leke te reja dhe perbehet nga kontributet si me poshte ;

Qatip Sufa me 50.000 Leke = me 1 kuote

Bejzad Sufa me 50.000 Leke = me 1 kuote

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer krejtesisht , pastaj jane ndare ndermjet ortakeve si me siper.

Cdo kuote I takon e drejte e nje vote.

**NENI 6**

Kapitali I shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe dop te marrin ortaket, por ne asnje rast njeri ortak nuk mund te detyroje ortakun tjeter te rrise kuoten e tij ne kapitalin e shoqerise.

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare, rezulton me I vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda tre muajve nga miratimi I llogaritjeve te percaktojne kete humbje, mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet shoqeria zvogelonkapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

shpallet shoqeria zvogelonkapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

**NENI 7**

Ortaku qe jka ndermend te shese te treteve kuotat e kapitalit te tij, teresisht ose pjeserisht, duhet te njoftoje me pare ortakun tjeter te shoqerise. qe ka te drejten e parablerjes qofte dhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

**NENI 8**

Organet drejtuese te shoqerise jane ;

Asambleja

Administrator

Procedura per emerimin ne funksione perkatese dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqerise.

**NENI 9**

Asamblea drejtohet nga administratori I shoqerise. Ortaket themelues te shoqerise kane zgjedhur si administrator te saj Z. Qatip Sufa.

**NENI 10**

Vendimet e asamblese jane te vlefshme , ne se jane miratuar nga te dy ortaket e saj. Vendimet e asamblese mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim, ne se nje nga ortaket nuk ka kerkuar bledhjen e asamblese.

**NENI 11**

Likujdimet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogarite e saj rrjedhese.

Per kapitalin thelemtar te shoqerise eshte hapur libri I llogarive ku do te shenohet kontributi I secilit ortak. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e te gjithe kerkesave te tjera financiare te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

**NENI 12**

Fitimi neto I realizuar nga shoqeria do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5 % qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore, deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

**NENI 13**

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

**NENI 14**

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit , te eksperiences te shkembyer, te realizuar, brenda veprintarise teshoqerise.

**NENI 15**

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykaten kompetente shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

**NENI 16**

Ne rast zgjidhje te kontrates, Asambleeja percakton menyren e likujdimit dhe emeron nje ose me shume likujdator sipas normave ligjore.

**NENI 17**

Kjo kontrate u perpilua ne prani te dy ortakeve duke shprehur ne te vullnetin e lire te tyre.

Kontratra u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per te depozituar ne organet gjyqesore dhe tatimore si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise,

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "SUFA" SHPK**

| | |
|---|---|
| **QATIP SUFA** | **BEZAT SUFA** |
| Qatip Sufa | Bezat Sufa |

# STATUT
# I
# SHOQERISE "SUFA" SHPK

## KREU 1
## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

**NENI 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar emertohet "SUFA" SHPK.

Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar. Shoqeria fiton te drejtene e personit juridik nga data e regjistrimit ne gjykate.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar me dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj, kontraten e kete statut si dhe me ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe ne baze te ligjit 7667 date 28 .1.1993, "per regjistrin Tregtar"

**NENI 2**

Shoqeria "SUFA" SHPK ka statusin e personit juridik dhe vulen e saj .

**NENI 3**

Shoqeria "SUFA" SHPK ka seline ne Republiken e Shqiperise, ne Damjan Vaqar te rrethit Tirane Ajo mun d te cele filiale, dege , e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

**NENI 4**

Pjesmarrja ne shoqeri nuk I pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejte pronesie jashte Shqiperise. Po keshtu Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj jashte veprimtarise se shoqerise.

**NENI 5**

Shoqeria 'Sufa" SHPK do te kete per objekt te veprimtarise se saj : Perpunim dhe tregtim te rrenjes se shqopes dhe marese, si dhe mbareshtimine pyjeve , pyllezime, permiresime pyjore , sistemime malore, shfrytezimin e pyjeve , rruget pyjore , mbareshtimin e flores spontane mjekesore e tanifere , mbareshtimin e faunes dhe gjuetine sportive e turistike , mbrojtjen nga semundjet , demtuesit dhe zjarret , mbareshtimin e kullotave dhe livadheve , ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe, tregtimin me shumice dhe me pakice I mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, fruta perime, pajisje elektrike ,elektroshtepiake, mallra te te gjitha llojeve, materiale dhe pajisje te ketyre mallrave industriale, prodhimi dhe tregtimi I pjeseve te tyre te kembimit,etj., eksport importin e te gjitha mallrave e materialeve .

## KREU II
## TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

**NENI 6**

Ortaket kane keto te drejta kryesore; te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e ortakeve:

- Te marrin pjese ne administyrimin e veprimtarive ekonomike tregtare te shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte sic parashikohet nga kontrata dhe statuti.
- Te kerkojne dhe tu jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te gjith dokumentat e perpunuara nga shoqeria si bilanci dhe llogaria ekonomike.
- Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato per shqyrtim ne organin administrativ.
- Te heqin dore nga shoqeria duke ua ofruar kuoten e tyre ortakeve te tjere te cilet kane ete drejten e pare te blerjes. Neqoftese brenda 60 diteve asnje nga ortaket nuk pranon blerjen e pjeses ai ka te drejte ta shese tek personat e trete.

**NENI 7**

**NENI 7**

Ortaket kane keto detyre kryesore :

-Te depozitojne kuoten e tyre dhe kuoten eventuale. suplementare, ne perputhje me kontraten dhe statutin.

-Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga ata vete.

-Ti japin shoqerise te dhena te domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante ne veprimtarine e saj.

-Te kryej detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve qe kane.

**NENI 8**

Secili ortak ka te drejte te heq dore nga shoqeria duke ia njoftuar me shkrim vendimin e tij organit administrativ 2 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e rrjedhjes sipas nenit 6.

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me para ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakut.

**KREU 3**

**KUSHTET EKONOMIKE**

**NENI 9**

Veprimtaruia e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

**NENI 10**

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise te shoqerise vihet nje kapital baze prej 100.000 leke te reja qe perbejne burimin fillestar per krijimin e fondit themeltar .

Ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit themeltar te shoqerise me kuotat e tyre qe percaktohen ne kontraten per krijimin e shoqerise.

**NENI 11**

Shoqeria do te kryeje veprimtarinee saj pa kufizim, ne cdo rast mbi 10 vjet. Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave ua ndan ortakeve ne perpjestim me kuoten e vene prej secilit per krijimin e jkapitalit baze te shoqerise.

**NENI 12**

Shoqeria eshte pronare perdoruese dhe disponuese e pasurive te saja, ne emer te vet, ne perputhje me qellimin dhe obejktivin e veprimtarise se saj.

Shoqeria mund te blere dhe shfrytezoje, te drejtat materiale ose jo , perfshire te drejten per te ofruar pasurite e saj dhe per te marre kredi bankare.

**NENI 13**

Shoqeria krijon findin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financiare ( per zzhvillimin e saj dhe per nxitjen ekonomike te valutes etj) Perberja shuma e pergjithshme burimet per krijimin e fondit rezerv, perdorimin dhe rregullimin I cdo fondi te vecante caktohen nga Asambleja e Ortakeve .

Shoqeria I disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera, ose nga shumat suplementare qe mund te derdhin ortaket kur detyrimet nuk mund te mbulohen nga fondet ekzituese,

**NENI 14**

E ardhura bruto e shoqerise pasi zbriten amortizimi I te gjitha pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme sipas rasteve te caktuara kuotat qe kane te bejne me kredite per investime, pagat dhe shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para ndihmese , apo energjine, si dhe per shpenzimet e pergjithshme te shoqerise dhe per ato qellime te tjera tregtare dhe jo tregtare etj. per rezerve financiare caktohet 5% e fitimit ( zbritur humbjet eventuale te viteve te meparshme te pambuluara). Derisa ky fond te arrije sa 10 % e fondit themeltar, pjesa e ngelur u ndahet ortakeve te shoqerise ne mase te barabarte sic eshte dhe kuota e tyre ne formimin e kapitalit te shoqerise.

Asamblea mund te vendose ete shpendaje shumat e vena menjeane per rezerven qe ajo ka ne dispozicion duke treguar shprehimisht llojet e rezervat ku jane marre koto shuma. Asnje shperndarje nuk

mund te behet nese kapitalet e veta jane ose do te beheshin pas kesaj shpendarjeje me te vogla se sa shuma e kapitalit qe nuk lejohet te shperndahet sipas ligjit apo statutit.

**NENI 15**

Bilancet vjetore duhet te paraqiten brenda dates 31 mars te vitit pas ardhes nga organi administrativ pasi ta kete shqyrtuar me par asambleja e ortakeve.

**NENI 16**

Veprimtaria financuiare e shoqerise realizophet ne baze te planeve financiare qe bejne pjese ne planin e veprimtarise ekonomike tregtare.

Planet financiare parashikojne aktivin dhe pasivin e veprimtarise te shoqersise te shprehura ne lek. Llogaria kontabel dhe ajo ekonomike mbahen ne lek . Rezultatet financiare te veprimtarise se shoqerise caktohen ne baze te bilancit vjetor.

Shkembimi I monedhes shqiptare ne monedhe te huaj behet ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar .

## KREU IV
## ADMINISTRIMI

**NENI 17**

Organi vendimor I shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve. Ne te marrin pjese ortaket me te drejte vote sipas madhesise se shumave te vena pre krijimin e kapitalit baze te shoqerise. Asambleja e ortakeve vendos per bilancin vjetor [per ndryshimet ne statut, per shtimin ose pakesimin e kapitalit theemelor te shoqerise, kundrejt te t treteve, per emerimin e organit administrativ si dhe per pushimin apo rritjen e veprimtarise te shoqerise. Percaktojne gjithashtu drejtimet kryesore te veprimtarise te shoqerise me shumice votash.

**NENI 18**

Organi administrativ I shoqerise emerohet ose riemerohet ne funnksionet e tyre nga asamblea e ortave, sipas propozimit te ortakeve, qe perfaqeson shoqerine, kundrejt te treteve brenda caqeve te objektit te veprimtarise se shoqerise, pervec ceshtjeve qe duhen vendosur nga Asamblea e ortakeve.

Administrator eshte Zoti Qatip Sufa.

**NENI 19**

Organin administrativ eshte kompetent per te marre vendime per :

- Te therrase Asamblene e ortakeve me shkrim 15 dite me pare.

- Te miratoje planet dhe llogarite ekonomike mujore dhe tremujore , pas perpunimeve te tyre ne kuadrin e objektit te shoqerise sipas nenit 5.

- Te bej propozimet e nevojshme ne asamblene e ortakeve per ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne rast nevoje.

-Te propozoje dokumenta normative qe perkufizojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire edhe kuadrin e personelit per te vendosur asamblene e ortakeve.

-Te propozoje strukturen e aparatit te shoqerise per te vendosur Asambleja e ortakeve.

-Te percaktoje ndarjen e vendeve te punes se atyre qe do te merren ne pune.

- Ti paraqese asamblese se ortakeve propozimet per rregullimin , krijimin dhe destinimin e fondeve te vecanta, ndarjen e fitimeve si dhe percaktimin e rregullave lidhur me shlyerjen e borxheve.

- Te paraqese propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise

- Te perzgjedhe anetaret e komisionit te likujdimit te cilet emerohen dhe revokohen nga asamblea e ortakeve.

-Te kryeje veprimtarite per likujdimin ellogarive qe u perkasin ortakeve doreheqes te shoqerise

-Te perfaqesojne shoqerine ne veprime gjyqesore .

**NENI 20**

Marredheniet e punes se shoqerise rregulloheen neepermjet kontrates se punes.

Per ceshjte qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispowitat e legjislacionit te punes .

**KREU V**

**MBYLLJA E SHOQERISE**

**NENI 21**

Veprimtaria e shoqerise pushon sipas propozimit te bere nga organi administrativ kur veprimtaria rezulton negative ose kur te gjith ortaket heqin dore nga shoqeria si dhe ne te gjitha rastet e tjera qe pqrqshikohen ne kontrate.

Shoqeria shpendahet ne formen e riorganizimit ose likujdimit .

**NENI 22**

Kur shoqeria likujdohet :

- Asamblea e ortakeve emeron komisionin e likujdimit te cilit I paraqer bilancin e likujdimit.

Shoqeria I jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit.

- Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerite me te drejte shfrytewimi I kthehen ortakut pronar dhe vleresimi I shfrytezimit te bere ( te gezuar) llogaritet ne shumen qe I duhet kthyer ortakut pronar.

Mjete financiare te fituara si rezultat I veprimtarise se shoqerise e te dilialeve te saj si dhe fondet e tyre financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

**NENI 23**

Kur pushon veprimtaria e nje filiali per efekte riorganiwimi te tij afatet e pushimit caktohen nga asambleja e ortakeve.

Likujdimi I filialeve behet ne te njejten menyre sic procedohet per shoqerine.

M<jete financiare te fituara si rezultat I veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise, pasi tu jene bere pagesat krediroreve.

Pasi behet njoftimi I mbylljes ose likujdimit dhe kryhen formalitetet perkatese shoqeria crregjistrohet ne regjistrin tregtar.

**KREU VI**

**DISPOZITAT E [PERGJITHSHME**

**NENI 24**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut I referohet plotesimeve qe do te behen nga asambleja e shoqerise si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar .

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedura me te cilen nxirret vete statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

**NENI 25**

Te gjitha kundershtimet eventuale ndermjet ortakeve te shoqerise ; I nenshtrohen kompetences te nje kolegji te perbere prej tre arbitrash nga te cilet secila pale cakton nga nje arbiter ndersa I treti caktohjet nga dy te paret ose nga kryetari I Gjykates se Rrethit. Arbitrat kerkojne zgjidhjen ne mirekuptim dhe vendimet e tyre do te pranohen nga palet ne konflikt si shprehje e vullnetit te tyre. Vendimet merren ne vendinm dhe kohen e parashikuar nga Asamblea e ortakeve.

**NENI 26**

Vendimet e kolegjit te arbitrave nese njera nga palet nuk eshte dakort mund te behen konflikt gjyqesor ne Gjykaten e rrethit.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "SUFA" SHPK.**

**QATIP SUFA** Qatip Sufa

**BE ZAT SUFA** Bezat Sufa

VENDIM NR 1 dt.16.09.2002

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE"SUFA" shpk

Me vendimin nr 19264 dt 17.04.1998 eshte rregjistruar person jurid

shoqeria SUFA shpk,me ortak Qatip Sufa e Bezat Sufa.

Administrator Z Qatip Sufa

Me vendimin nr 1 dt 16.09.2002 Asambleja e ortakeve ka vendosur:

Te shtoj objektin e veprimtarise ne fushen:

Prodhim e tregetim llullash,import-eksport

Tregetim materiale ndertimi,prodhim e tregetim qymyr druri si dhe

artikuj artistik te te gjitha llojeve me materiale druri e qeramik

Tregetim karburantesh e vajrash lubrifikante me pakice.

Lutemi te na rregjistrohet vendimi

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

QATIP SUFA | BEZAT SUFA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

NR 5335 REP

NR 311 KOL VERTETIM

Tirane me 16.09.2002

Sot me dt 16.09.2002 para meje noteres Manushaqe Sharka me zyre per balle Gjykates rrethit Tirane rruga Gjergj Fishta u paraqiten: Qatip Sufa i biri Mexhitit dtl 1954 banues ne Damjan Vaqar i paisu me pasaporten nr AZ 372945 dhe Bezat Mexhit Sufa i dtl.1963,banues ne Damjan Vaqar i paisur me pasaporten nr 0820243,madhor dhe me zot si juridike te plote per te vepruar,te cilet kerkuan vertetimin e nenshkrimit te hedhur ne kete vendim.

Sa siper vertetohet edhe prej meje noteres.

NOTERE

MANUSHAQE SHARKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE MANUSHAQE NOTER TIRANE

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

**SHOQERIA "SUFA" SH.P.K**

**Damjan**
**Vaqar**
**TIRANE**

# V E N D I M

## I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE "SUFA" SH.P.K.

Asambleja e Jashtezakonshme te Shoqerise "SUFA"Sh.p.k. e mbledhur sot me daten 28.06.2005 pasi mori ne shqyrtim rendin e dites te caktuar nga administratori I saj per miratimin e llogarive vjetore, si dhe percaktimin e destinacionit te fitimeve te realizuara deri me 31.12.2004,

## K O N S T A T O I S E :

Z.Qatip Sufa me cilesine e administratorit ne shoqerine"SUFA" Sh.p.k. me ortake Z.Qatip Sufa dhe Z.Bezat Sufa ka kerkuar ne asamblene e shoqerise miratimin e llogarive vjetore te ushtrimit 2004, si dhe percaktimin e destinacionit te fitimeve te realizuara sipas dokumentacionit qe disponon shoqeria.
Ne shqyrtimin,analizimin e bere nga ortaket e shoqerise u shpreh per dokumentacionin qe paraqiti drejtimi I shoqerise per llogarite vjetore te ushtrimit 2004 sipas Statutit te Shoqerise dhe Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" asambleja e ortakeve te shoqerise,

## V E N D O S I

1. Miratimin e llogarive vjetore sipas dokumentacionit te paraqitur si Bilanci Kontabel te ushtrimit 2004 se bashku me pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve.

2. Fitimet e realizuara nga shoqeria per vitin ushtrimor te mos shperndahen ne forme dividenti, por te kalojne ne shtese kapitali, te kapitalizohen.

3. Miratimin e znj.Leze Abazi si eksperte kontabel e autorizuar me Licence nr.24, date 11.01.2000 per hartimin e raportit per shtesen e kapitalit nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri me 31.12.2004 sipas dokumentacionit qe disponon ajo.

Vendimi u mor nga ortaket.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "SUFA" SH.P.K.**
**Z.Qatip SUFA**
**Z.Bezat SUFA**

SUFA Sh.p.k
Imp exp
TIRANA ALBANIA

**SHOQERIA "SUFA" SH.P.K**

**Damjan**
**Vaqar**
**TIRANE**

## V E N D I M

## I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE "SUFA" SH.P.K.

Asambleja e Jashtezakonshme te Shoqerise "SUFA"Sh.p.k. e mbledhur sot me daten 28.06.2005 pasi mori ne shqyrtim rendin e dites te caktuar nga administratori I saj per miratimin e llogarive vjetore, si dhe percaktimin e destinacionit te fitimeve te realizuara deri me 31.12.2004,

## K O N S T A T O I S E :

Z.Qatip Sufa me cilesine e administratorit ne shoqerine"SUFA" Sh.p.k. me ortake Z.Qatip Sufa dhe Z.Bezat Sufa ka kerkuar ne asamblene e shoqerise miratimin e llogarive vjetore te ushtrimit 2004, si dhe percaktimin e destinacionit te fitimeve te realizuara sipas dokumentacionit qe disponon shoqeria.
Ne shqyrtimin,analizimin e bere nga ortaket e shoqerise u shpreh per dokumentacionin qe paraqiti drejtimi I shoqerise per llogarite vjetore te ushtrimit 2004 sipas Statutit te Shoqerise dhe Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" asambleja e ortakeve te shoqerise,

## V E N D O S I

1. Miratimin e llogarive vjetore sipas dokumentacionit te paraqitur si Bilanci Kontabel te ushtrimit 2004 se bashku me pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve.

2. Fitimet e realizuara nga shoqeria per vitin ushtrimor te mos shperndahen ne forme dividenti, por te kalojne ne shtese kapitali, te kapitalizohen.

3. Miratimin e znj.Leze Abazi si eksperte kontabel e autorizuar me Licence nr.24, date 11.01.2000 per hartimin e raportit per shtesen e kapitalit nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri me 31.12.2004 sipas dokumentacionit qe disponon ajo.

Vendimi u mor nga ortaket.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "SUFA" SH.P.K.**
**Z.Qatip SUFA**
**Z.Bezat SUFA**

" SUFA ,,Sh p k
imp exp
TIRANA ALBANIA

**SHOQERIA "SUFA" SH.P.K**
**Vaqar**
**TIRANE**

**V E N D I M**

**I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE "SUFA"SH.P.K.**

Asambleja e Jashtezakonshme te Shoqerise "Sufa"Sh.p.k. e mbledhur sot me daten 22.07.2005 pasi mori ne shqyrtim rendin e dites te caktuar nga administratori i saj per miratimin e raportit te ekspertit per zmadhim (shtim) te kapitalit.

K O N S T A T O I   S E :

Me Vendimin e dates 28.06.2005 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise "Sufa "Sh.p.k. eshte miratuar kerkesa e ortakeve te shoqerise per zmadhim te kapitalit te shoqerise sipas raportit qe do te hartohet nga eksperti kontabel I autorizuar per vleresimin e kontributeve nga fitimet e realizuara, rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004.
Ne diskutimet e bera nga ortaket e shoqerise u shprehen per raportin e ekspertes kontabel te autorizuar zj.Leze Abazi, lidhur me shumat e pasqyruara ne raportin e hartuar dhe dokumentacionin baze bashkengjitur ketij raporti per vleresimin te kapitalit qe do te zmadhohet ne formen e kontributeve nga ortaket e shoqerise nga fitimet e rezervat deri me 31.12.2004.
Per sa me larte ne mbeshtetje te Statutit te Shoqerise dhe neneve 61, 63 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" asambleja e jashtezakonshme e shoqerise,

V E N D O S I

1.Miratimin per zmadhim te kapitalit prej 7.448.000 leke, pra nga 100.000 leke qe ishte te behet prej 7.548.000 leke nga fitimet e realizuara e rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004, sipas raportit te ekspertit kontabel.

2.Kapitali zoterohet nga ortaket sipas perqindjeve te pjesemarrjes:
z.Qati Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke,
z.Bezat Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke.

3.Gjithe dokumentacioni I pregatitur per zmadhimin e kapitalit themaltar nga fitimet deri me 31.12.2004 te Shoqerise"Sufa"Sh.p.k. te depozitohet ne regjistrin tregtar sipas kerkesave te Ligjit ''Mbi Shoqerite Tregtare '' dhe statutit te shoqerise.

Vendimi u miratua nga ortaket.

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E SHOQERISE "SUFA"SH.P.K.

Qatip Sufa                Bezat Sufa

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "SUFA "SH.P.K

# V E N D I M

**Nr. 2 date 17/5/2006**
**"I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE**
**" SUFA " sh.p.k**

Sot me daten 17.05.2006, Asambleja e ortakeve pasi mori ne shqyrtim rendin e dites me objekt pranimin e ortakeve nepermjet shitjes se kuotave te kapitalit themeltar dhe shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise;

## K O N S T A T O I

Shoqeria "Sufa" SH.P.K me seli ne Tirane eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.19264 date 17.04.1998, i ndryshuar se fundi me vendimin nr.19264/1 date 18.09.2002 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me ortaket Themelues Qatip e Bezat Sufa me nga 50 % te kapitalit themeltar sejcili, me Administrator te shoqerise Z.Qatip Sufa, me kapital themeltar 100.000 leke, me afat veprimtarie mbi 10 vjet, dhe objekt veprimtarie sipas akt-themelimit dhe statutit te shoqerise.

**Asambleja e ortakeve ne mbledhjen e saj shqyrtoi rendin e dites per :**

**1**.Shitjen e 60 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqertise nga Ortaket Qatip e Bezat Sufa, ortakeve Sabit,Ajet,Lulzim e Izet Sufa ose nga 15% te kuotave te kapitalit me kontraten per seicilin nga bleresit , keshtu mbas nenshkrimit te kontrates se shitblerjes se kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "SUFA" sh.p.k ,ortaket e shoqerise Qatip, Bezat Sufa,mbeten ortak me nga 20% ,kurse Sabit, Ajet,Lulzim e Izet Sufa, behen ortak ne kete shoqeri dhe,do te zoterojne nga 15% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SUFA" sh.p.k.

**2.**Shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise "SUFA' sh.p.k edhe ne fushen e ndertim-montimit dhe operator te prodhimit te energjise eletrike, te venies ne perdorim te hidrocentraleve te rinje, te kapaciteteve te vegjel e te mesem.Transformimin dhe shperndarje te energjise eletrike.

**3.** Administratori i shoqerise mbetet z.Qatip SUFA.

Per aresyet e mesiperme Asambleja e ortakeve, ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe dispozitave te statutit,

## V E N D O S I

**1.**Pranimin si ortak ne shoqerine "SUFA" sh.p.k. te Sabit, Ajet, Lulzim dhe Izet Sufa, qe nepermjet kontrates se shitjes se kuotave , behen ortak me nga 15 % te kuotave te kapitalit themeltar sejcili.

**2.**Shtimin e objektit te veprimtarise se shoqeris "SUFA" sh.p.k. edhe me ndertimi-montim dhe operator te prodhimit te energjise eletrike, te venjes ne perdorim te hidrocentraleve te rinje te kapaciteteve te vegjel e te mesem. Transformimin dhe shperndarjen e energjise eletrike.

**3.**Mbas nenshkrimit te ketij vendimi shoqeria "SUFA" sh.p.k. behet me 6 ortake dhe konkretisht: Qatip e Bezat Sufa me nga 20 % te kuotave te kapitalit themeltar ,kurse Sabit, Ajet, Lulzim dhe Izet Sufa, me nga 15% te kuotave te kapitalit themeltar sejcili,. Administratori i shqoqerise mbetet Z.Qatip SUFA.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "SUFA" SH.P.K

1. Qatip Sufa        2. Bezat Sufa

PULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
Nr. 9239 Rep
Nr. 607 Kol

***KONTRATE SHITJE KUOTASH***

Ne Tirane ,sot me daten 18 .06.2006 (dymije ~~e gjashte~~ ),para meje noterit publik Halil Sinani,me zyre ne Rr."P.e Rilindjes" u paraqiten personalisht palet

SHITESA:QATIP SUFA,i biri i Mexhitit,i datl.16.05.1954,lindur ne Diber dhe me banim ne, identifikuar me deshmin e aftesise nr.902683.

2.BEZAT SUFA,i biri i Mexhitit,i vitlindjes 1963,lindur ne Diber dhe me banim ne Damjan Tirane,identifikuar me pasaporten nr.0820243.

BLERESA :1.SABIT SUFA,i datl.27.06.1960,lindur ne Diber dhe me banim ne Tirane,identifikuar me pasaporten nr.1593766.

2.AJET SUFA,i datl.01.11.1964,lindur ne Diber dhe me banim ne Tirane, identifikuar me pas.Z1011279 .

3.LULZIM SUFA ,i biri i Sejjdis ,i datl.23.05.1970,lindur ne Diber dhe me banim ne Tirane ,identifikuar me certefikaten me fotografi nr.2-20 ,date 16.05.2006,leshuar nga zyra e gjendjes civile Vaqarr

4.IZET SUFA,i biri i Mexhitit,i datl.25.04.1970,lindur ne Diber dhe me banim ne Tirane ,Damjan Komuna Vaqarr Tirane,identifikuar me certefikaten me fotografi nr.1-82,date 16.05.2006.

Te gjithe jane madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet kerkuan perpilimin e kontrates se shitjes se kuotave.

Me vendimin Nr.19264 date 17.04.1998,te Gjykates se shkalles se Pare Tirane eshte krijuar shoqeria Tregetare " SUFA "shpk,ky vendim eshte ndryshuar se fundi me vendimin nr.19264/1,date 18.09.2002,te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me ortaket e shoqerise tregtare " SUFA"shpk,Qatip e Bezat Sufa.Te dy jane ortake ne masen 50% sejcili te kuotave te kapitalit themeltar,Qatip Sufa eshte administratori i kesaj shoqerise,me afat te veprimtarise mbi 10 vjet dhe aktivitet sipas aktit te themelimit dhe statutit .

Me vendimin nr.2 date 17.05.2006,te ortakeve eshte vendosur qe ortaket Qatip e Bezat Sufa,tu shesin ortakeve Sabit ,Ajet,Lulzim e Izet Sufa ,60 % te pjeses se tyre te kuotave te kapitalit fillestar te depozituara per krijimin e shoqerise ne shumen 60.000 (gjashtedhjetmije) leke te reja,duke mbetur perseri te dy ortake ne shoqerine "SUFA" shpk,50% qe ishin para realizimit te kesaj shitje ne 20 % te kuotave te kapitlit fillestar te depozituar per krijimin e shoqerise.Qatip Sufa mbetet perseri administrator te shoqerise " SUFA "shpk

Ne zbatim edhe te vendimit te lartepermendur te ortakeve, Qatip e Bezat Sufa,me vullnetin e tyre te lire dhe te plote deklaruan se U shesin ortakeve te tjere Sabit,Ajet,Lulzim e Izet Sufa 60 % te kuotave te kapitalit fillestar qe eshte derdhur per krijimin e shoqerise "SUFA "shpk ne shumen 60.000 (gjashtedhjetmije) leke te reja .Edhe bleresat e aksioneve Sabit ,Ajet,Lulzim e Izet Sufa deklaruan se kane blere dhe kane likujduar totalisht para nenshkrimit

te kesaj kontrate dhe jashte kesaj zyres se noterise ne favor te shitesave Qatip e Bezat Sufa 60% te kuotve te kapitalit, ose ne shumen prej 60.000 ( gjashtedhjetmije) leke te reja,sejcili prej blersave nga 15% te kuotave te kapitalit themeltar .

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitblerje te kuotave te kapitalit shitesat Qatip e Bezat Sufa,mbeten ortak i shoqerise " SUFA "shpk sejcili prej tyre do te zoterojne nga 20 % te kuotave te kapitalit themeltar.Kurse blersat Sabit, Ajet,Lulzim e Izet Sufa,mbas nenshkrimit te kesaj kontrate behen ortak te shoqerise "SUFA"shpk dhe do te zotrojne sejcili prej tyre nga 15% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " SUFA"shpk. Qatip Sufa mbetet perseri administartori i shoqerise se lartepermendur .

Kontrata u redaktua ne baze te nenit 705 e vujuesa te K.CIVIL.

Kontrata u redaktua nga une noteri ,u lexua me ze te larte dhe pasi palet deklaruan se jane dakort me permbajtjen e saj e nenshkruan ate rregullisht.

Une noteri vertetoj nenshkrimet sipas ligjit.

| SHITESA | BLERESA | NOTERI |
| --- | --- | --- |
| Qatip Sufa | Sabit Sufa | HALIL SINANI |
| Bezat Sufa | Ajet Sufa | |
| | Izet Sufa | |
| | Lulzim Sufa | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
Nr. 9246 Rep.
N. 609 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane,sot me date 13.06.2006 (dymije e gjashte),para meje noterit publik Halil Sinani,me zyre ne Rr."P.e Rilindjes ",u paraqiten personalishte

**1.Qatip Sufa**,i biri i Mexhitit,i dtl.16.05.1964,lindur ne Diber dhe me banim ne Damjan Komuna Vaqarr Tirane,i identifikuar me deshmin e aftesise nr.902683.

2.Bezat Sufa,i biri i Mexhitit,i vitlindjes 1963,lindur ne Diber dhe me banim ne Damjan Komuna Vaqarr –Tirane,identifikuar me pasaporten nr.0820243,paraqitur me cilesin e ortakve te shoqerise :SUFA "shpk ,te dy jane madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar ,te cilet kerkuan vertetimin e nenshkrimeve te bera ne vendimin nr.2,date 17.05.2006.te "Asamblese se Ortakve ",te shoqerise "SUFA"shpk. Per shitjen e 60% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet kontrates se shitjes dhe pranimin ne shoqeri te ortakve te caktuar ne kete vendim.

Une noteri e vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

N O T E R I
HALIL SINANI



Gj: A. Caco
15.06.2006

19264/4

15 QERSHOR 2006

# KERKESE

**Kerkues : QATIP SUFA,**i biri i Mexhitit,i datl.16.05.1964,lindur ne Diber dhe me banim ne Damjan Komuna Vaqarr –Tirane .

**Objekti** :Depozitimin e vendimit Nr.2,date 17.05.2006,te Asamblese se Ortakeve Per shitjen e 60% te kuotave te kapitalit themeltar kater ortakve te tjere dhe,shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise edhe ne fushem hidroenegjitike.

**Baza ligjore** :Ligji nr.7638 ,date 19.11.1992 dhe ligji nr.7667,date 28.01.1993.

**PERPARA : Gjykates se Rrethit Gjyqesor**
**TIRANE**

Shoqeria "SUFA"shpk eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.19264,date 17.04.1998,i ndryshuar se fundi me vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ,nr.19264/1,date 18.09.2002,me ortaket themelues zoterijt Qatip e Bezat Sufa,te cilet zotrojne sejcili nga 50% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Sufa"shpk,me administartor te shoqerise Z.Qatip Sufa.Shoqeria eshte me seli ne Tirane ,me kohe zgjatje mbi 10 vjet dhe, me objekt te veprimtarise sipas akt – themelimit,Statutit,me ndryshimet perkatese te bera me vendimet e gjykates.

Asambleja e oratkeve ne mbledhjen e dates 17.05.2006,mbasi shqyrtoj kerkesen e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "SUFA" shpk,per depozitimin e vendimit nr.2,te Asamblese se ortakeve date 17.05.2006,per :

1.Shitjen nga dy ortaket Qatip e Bezat Sufa te 60% te kuotave te kapitalit themeltar ortakeve Sabit,Ajet, Lulzim,e Izet Sufa me anen e kontrates se shitjes dhe;

2.Shtimin e objekktit te veprimtarise se shoqerise "Sufa"shpk edhe per :Ndertim-montim dhe operator te prodhimit te energjise elektrike ,te venjes ne perdorim te hidrocentraleve te rinje ,te kapaciteteve te vegjel e te mesem .Transformimin dhe shperndarjen e energjise elektrike.

Mbas nenshkrimit te kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit themeltar nga ortaket Qatip e Bezat Sufa,te cilet mbeten perseri ortak te shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar "SUFA"shpk,dhe zotrojne nga 20% te kuotave te kapitalit themeltar sejcili,kurse Z.Sabit,Ajet,Lulzim,dhe Izet Sufa,behen ortake te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Sufa"shpk,dhe zotrojne sejcili prej tyre me nga 15% te kuoatve te kapitalit themeltar te shoqerise "SUFA "shpk,shoqeri e cila behet me gjashte ortake.

Administyratori i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Sufa "shpk mbetet Z.Qatip Sufa.

Per sa me siper ,ne baze te Ligjit nr.7638,date 19.11.1992 dhe ligjit nr.7667,date 28.01.1993,kerkohet depozitimi i vendimit ne rregjistrin tregetar.

Në depozitohet kerkesa dhe aktet dt 27.06.2006
vendimi nr 2 dt 17.05.06
kontrate shitje kuotash
nr 1256 rep 607 kol
dt 15.06.2006
Arkivist
Ariana Garibaldi

KERKUESI
ADMINISTARTORI
I shoqerise " SUFA "shpk
Qatip Sufa

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
Nr. 9245 Rep.
Nr. 608 kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane,sot me date 13.06.2006 (dymije e gjashte),para meje noterit publik Halil Sinani,me zyre ne Rr."P.e Rilindjes ",u paraqite personalishte :**Z.Qatip Sufa**,i biri i Mexhitit,i dtl.16.05.1964,lindur ne Diber dhe me banim ne Damjan Komuna Vaqarr Tirane,i identifikuar me deshmin e aftesise nr.902683,paraqitur me cilesin e administratorit te shoqerise :SUFA "shpk ,eshte madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar ,i cili kerkoj vertetimin e nenshkrimit te bere ne kerkesen drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ,per depozitimin e vendimit nr.2,date 17.05.2006.te "Asamblese se Ortakve " ,te shoqerise "SUFA"shpk.

Une noteri e vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

N O T E R I
HALIL SINANI



REPUBLIKA E ShQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 2832 REP

**VERTETIM NOTERIAL**

Sot me dt 22.07.2005 (dy mije e pese)diten e premte para meje **Notere Tamara Malaj** Notere ne Tirane,me seli ne Rr.L.Gurakuqi pall 2 u paraqit personalisht :- - - - -

**Z.QATIP SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 16.05.1954 banues ne Tirane,Damjan."Vaqarr" i paisur me pasaporten me nr AZ 372945, **Administrator i Shoqerise "SUFA" SH.P.K.** rregjistruar si person Juridik me Vendimin nr 19264 dt, 17.04.1998 t Gjykates se Rrethit Tirane.I lartpermenduri eshte madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,i cili deklaroi se sa me siper eshte nje akt i hartuar me vullnetin e tij te lire e te plote,jashte kesaj zyre.Une Noteria pasi konstatova se sa me siper nuk vjen ne kundershtim me ligjin e interesat e paleve pasi u nenshkrua ne pranine time, une noteria e vertetoj ate rregullisht.

Tirane me 22.07.2005

**NOTERE**
**TAMARA MALAJ**

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI P. 2 AP. 21
TIRANE

TAKSA E PULLES
U PAGUA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter: Robert Koli
Studio: Rr.Urani Pano, P 11.Katesh
Nr. 9556 Rep.

## *VERTETIM NOTERIAL*

Sot me daten 25.07.2005 (dymijepese), para meje Robert KOLI noter ne qytetin e Tiranes, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

***Znj. Leze ABAZI***, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje, e cila me deklaroi se ***Raportin per Vleresimin e Zmadhimit te Kapitalit te Shoqerise "SUFA" SHPK*** te bashkangjitur e ka hartuar me vullnet te lire dhe e neneshkroi rregullisht para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

***NOTER***
Robert KOLI

**SUFA SHPK**
**NIPT J71611003A**
**3707818**

# P E R C J E L L S E

Bashkengjitur keni procesverbalin e gjendjes se arkes dhe te bankes ne daten 31.12.2004 per efekt paraqitje ne gjykate per kapitalizim fitimi.

**Administratori**

**Qatip Sufa**

" SUFA " Sh p k
imp exp
TIRANA ALBANIA

REPUBLIKA E ShQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 2597 REP

# VERTETIM NOTERIAL

Sot me dt 22.07.2005 (dy mije e pese)diten e premte para meje **Notere Tamara Malaj** Notere ne Tirane,me seli ne Rr.L.Gurakuqi pall 2 u paraqit personalisht :- - - - -

**Z.QATIP SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 16.05.1954 banues ne Tirane,Damjan."Vaqarr" i paisur me pasaporten me nr AZ 372945, **Administrator i Shoqerise "SUFA" SH.P.K.** rregjistruar si person Juridik me Vendimin nr 19264 dt, 17.04.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane.

**Z.BEZAT SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 02.05.1963 banues ne Tirane Damjan „Vaqarr" i njohur prej meje noteres personalisht.Te lartpermendurit jane madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,te cilet deklaruan se sa me siper eshte nje akt i hartuar me vullnetin e tyre te lire e te plote,jashte kesaj zyre.Une Noteria pasi konstatova se sa me siper nuk vjen ne kundershtim me ligjin e interesat e paleve pasi u nenshkrua ne pranine time, une noteria e vertetoj ate rregullisht.

Tirane me 22.07.2005

NOTERE
TAMARA MALAJ

PULLE TAKSE
50 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI . P.2. AP. 21
TIRANE
TEL. 2 98 72

REPUBLIKA E ShQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 2580 REP

## VERTETIM NOTERIAL

Sot me dt 22.07.2005 (dy mije e pese)diten e premte para meje **Notere Tamara Malaj** Notere ne Tirane,me seli ne Rr.L.Gurakuqi pall 2 u paraqit personalisht :- - - - -

**Z.QATIP SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 16.05.1954 banues ne Tirane,Damjan."Vaqarr" i paisur me pasaporten me nr AZ 372945, **Administrator i Shoqerise "SUFA" SH.P.K.** rregjistruar si person Juridik me Vendimin nr 19264 dt, 17.04.1998 t Gjykates se Rrethit Tirane.I lartpermenduri eshte madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,i cili deklaroi se sa me siper eshte nje akt i hartuar me vullnetin e tij te lire e te plote,jashte kesaj zyre.Une Noteria pasi konstatova se sa me siper nuk vjen ne kundershtim me ligjin e interesat e paleve pasi u nenshkrua ne pranine time, une noteria e vertetoj ate rregullisht.

Tirane me 22.07.2005

NOTERE
TAMARA MALAJ

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI, P.2, AP. 2
TIRANE

TAKSA E HELLES
U.PAGUA

(3) 19264/3 Regjistro Parregjets

16 SHTATOR 2005

# KERKESE

**Kerkuesit**:zQatip Sufa I biri I Mexhitit, lindur me 1954 dhe banues ne Damjan Vaqar Tirane, me cilesine e administratoreve te Shoqerise "SUFA"SH.P.K.

**Objekti:**Kerkoj depozitimin ne regjistrin tregtar prane asaj gjykate te Vendimit dhe te Proces-verbalit te dates 22.07.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "Sufa"Sh.p.k. Per miratimin e raportit te ekspertit per shtesn e kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2004, ne baze te Ligjit Nr.7667,date 28.01.1993"Per regjistrin tregtar dhe…"

**Gjykates se Shkalles se Pare**
**T i r a n e**

Shoqeria "Sufa"Sh.p.k. eshte regjistruar si person juridik me Vendimin nr.19264 date 17.04.1998 te Gjykates se rrethit Tirane.

Me Vendimin e dates 22.07.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise **"SUFA"SH.P.K.**per miratimin e raportit te eskpertit kontabel te autorizuar per shtesen e kapitalit te shoqerise eshte vendosur:

1.Miratimin per zmadhim te kapitalit prej 7.448.000 leke, pra nga 100.000 leke qe ishte te behet prej 7.548.000 leke nga fitimet e realizuara e rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004, sipas raportit te ekspertit kontabel.

2.Kapitali zoterohet nga ortaket sipas perqindjeve te pjesemarrjes:
1-z.Qati Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke,
2-z.Bezat Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke.

3.Gjithe dokumentacioni I pregatitur per zmadhimin e kapitalit themaltar nga fitimet deri me 31.12.2004 te Shoqerise"Sufa"Sh.p.k. te depozitohet ne regjistrin tregtar sipas kerkesave te Ligjit ''Mbi Shoqerite Tregtare '' dhe statutit te shoqerise.

Per sa siper kerkojme qe vendimet e marra ne Asamblene e Jashtezakonshme te Shoqerise**"SUFA"SH.P.K.** te depozitohen ne regjistrin tregtar te gjykates.

Bashkelidhur ju paraqesim dokumentet e nevojshme.

Tirane, me 22.07.2005

**ADMINISTRATORI I SHOQERISE "SUFA"SH.P.K.**

**Qatip SUFA**

1) Raport i ekspertit dt 22-7-2005 nr 9556 Rep

2) Vendim asamblese 22-7-2005 dt 22-07-2005 nr 2597 Rep.

3) ...

REPUBLIKA E ShQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 2234 REP

## VERTETIM NOTERIAL

Sot me dt 28.06.2005 (dy mije e pese)diten e marte para meje **Notere Tamara Malaj** Notere ne Tirane,me seli ne Rr.L.Gurakuqi pall 2 u paraqiten personalisht :- - - - -

**Z.QATIP SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 16.05.1954 banues ne Tirane,Damjan."Vaqarr" i paisur me pasaporten me nr AZ 372945.----

**Z.BEZAT SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 02.05.1963 banues ne Tirane,Damjan."Vaqarr" i paisur me pasaporten me nr Z 0148688.---

Te lartpermendurit jane madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,te,cilet deklarojne se sa me siper eshte nje akt i hartuar me vullnetin e tyre te lire e te plote,jashte kesaj zyre.Une Noteria pasi konstatova se sa me siper nuk vjen ne kundershtim me ligjin e interesat e paleve pasi u nenshkrua ne pranine time, une noteria e vertetoj ate rregullisht.

Tirane me 28.06.2005

**NOTERE**
**TAMARA MALAJ**

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI . P.2. AP. 2
TIRANE
TEL. 2 98 3?

REPUBLIKA E ShQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 2234 REP

**VERTETIM NOTERIAL**

Sot me dt 28.06.2005 (dy mije e pese)diten e marte para meje **Notere Tamara Malaj** Notere ne Tirane,me seli ne Rr.L.Gurakuqi pall 2 u paraqiten personalisht :- - - - -

**Z.QATIP SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 16.05.1954 banues ne Tirane,Damjan."Vaqarr" i paisur me pasaporten me nr AZ 372945.----

**Z.BEZAT SUFA** i biri Mexhit dhe Xhevrie lindur ne Diber me 02.05.1963 banues ne Tirane,Damjan."Vaqarr" i paisur me pasaporten me nr Z 0148688.---

Te lartpermendurit jane madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,te,cilet deklarojne se sa me siper eshte nje akt i hartuar me vullnetin e tyre te lire e te plote,jashte kesaj zyre.Une Noteria pasi konstatova se sa me siper nuk vjen ne kundershtim me ligjin e interesat e paleve pasi u nenshkrua ne pranine time, une noteria e vertetoj ate rregullisht.

Tirane me 28.06.2005

**NOTERE**
**TAMARA MALAJ**

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI . P.2. AP. 2
TIRANE
TEL. 2 98 ??

19264/2

# KERKESE

**KERKUESI** : 1-Qatip Sufa , i biri i Mexhitit, dtl 1954, banues ne Damjan, Vaqar, Tirane , adminsitrator dhe ortak i shoqerise " SUFA " Sh p k .
2-Bezat Sufa , i biri i Mexhitit , dtl 1963, banues ne Damjan, Vaqar, Tirane , ortak i shoqerise " SUFA " sh p k

**OBJEKTI**: Kerkojme depozitimin ne rregjistrin tregtar prane kesaj Gjykate te vendimit te dates 28.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise " SUFA " sh p k per miratimin e llogarive vjetore te ushtrimit 2004 si dhe miratimin e ekspertit kontabel te autorizuar per hartimin e raportit per shtesen e kapitalit nga fitimet e realizuara deri ne 31.12.2004.

**BAZA LIGJORE**: Ligji Nr.7638, dt.19.11.1992 "Per Shoqerite tregtare" dhe Ligji Nr.7667, dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar

**Perpara:** **GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**
TIRANE

Shoqeria " SUFA " Sh p k eshte rregjistruar si person juridik me vendimin Nr 19264 date 17.04.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane .
Me vendimin e dates 28.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise " SUFA " Sh p k per miratimin e llogarive vjetore si dhe percaktimin e destinacionit te fitimeve te realizuara nga shoqeria deri ne fund te vitit 2004 eshte vendosur:

1-Miratimin e llogarive vjetore sipas dokumentacionit te paraqitur si Bilancit Kontabel te ushtrimit 2004 se bashku me pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve.
2-Fitimet e realizuara nga shoqeria per vitin ushtrimor te mos shperndahen ne forme dividenti por te kalojne ne shtese kapitali , te kapitalizohen.
3-Miratimin e znj. Leze Abazi si eksperte kontabel e autorizuar me License nr 24 date 11.01.2000 per hartimin e raportit per shtesen e kapitalit nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri ne 31.12.2004 sipas dokumentacionit qe disponon ajo.

**ORTAKET**

**QATIP SUFA** " SUFA " Sh p k imp exp TIRANA ALBANIA **BEZAT SUFA**

REPUBLIKA E SHQIPERSIE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 2239 REP.

## VERTETIM

Sot me date 28 /06 /2005, para meje noterit publik , me seli ne Tirane, u paraqiten personalisht

1-z. Qatip Sufa , i biri i Mexhitit , lindur ne 16.05.1954,lindur ne Diber e banues ne Tirane , Damjan, Vaqar, shtetas shqiptar, i identifikuar prej meje nepermjet dokumentit perkates pasaportes nr AZ 372945

2-Bezat Sufa i biri i Mexhitit, lindur ne Diber e banues ne Tirane , Damjan , Vaqar,. Tirane madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakeve te shoqerise " SUFA " sh.p.k, te cilet me deklaruan se dokumentin e mesiperm e kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tyre te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERI**

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI . P.2. AP. 2
TIRANE



K E R K E S E

KERKUES

QATIIP SUFA i biri Mexhitit dtl 1954 me banim ne Damjan Vaqar

Tirane

ME OBJEKT

Shtim objekt veprimtarie

BAZE LIGJORE

Ligja "Mbi shoqerite tregetare"

PARA GJYKATES SHKALLES PARE

T I R A N E

Me vendimin nr 19264 dt 17.04.1998 eshte rregjistruar shoqeria SUFA shpk.

Me vendimin nr 1 dt 12.09.2002 asambleja e ortakeve ka vendosur Te shtoj objektin e veprimtarise nr :

Prodhim e tregetim llullash,import eksport

Tregetim materiale ndertimi,prodhim e tregetim qymyr druri si dhe artikuj artistik te te gjitha llojeve me materiale druri e qeramike

Tregetim karburantesh e vajra lubrifikante me pakice.

Lutemi te na pranohet kerkesa.

ADMINISTRATORI

QATIP SUFA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 5277 REP

Tirane me 12.09.2002

VERTETIM

Sot me dt 12.09.2002 para meje noteres Manushaqe Sharka me zyre perballe Gjykates rrethit Tirane rruga Gjergj Fishta u paraqit kerkuesi Qatip Sufa i paisur me dokument identifikimi i cili kerkoi vertetimin e neshkrimit hedhur ne kete kerkese.

Sa siper vertetohet edhe prej meje noteres.

NOTERE
MANUSHAQE SHARKA

BANCA ITALO ALBANESE
BANKA ITALO-SHQIPTARE

DATA: 16 06 ...

**VERSAMENTO**
EFFETTUATO PRESSO LA DIPENDENZA

S/C CORRENTE N. 806416

VALUTA: Lek

INTESTATO A: BUFA Sh.p.k

## DISTINTA DEGLI ASSEGNI E DEI VAGLIA (DA COMPILARE A CURA DEL CLIENTE)

| ISTITUTO PIAZZA AGENZIA | NAT TIT | SERIE E NUMERO | DATA | TRAENTE O NUMERO C.C | IMPORTO |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |

TOTALE ASSEGNI E VAGLIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE MIRANDA XHOMAQI NOTERE TIRANE

BANCA ITALO - SHQIPTARE
BANCA ITALO - ALBANESE
TIRANA - ALBANIA

PAGUAR - 4 - PAGATO

**BIGLIETTI BANCA E MONETA**

| N. | TAGLIO | IMPORTO |
|---|---|---|
| 200 | 500 | 100000 |

TOT. CONTANTI

TOTALE: 100000

IMPORTO VERSAMENTO IN CIFRE: 100000

IN LETTERE: CENTOMILA Lek

RESTO

IL RISCONTRO

IL CASSIERE

| VALUTA | DISPONIBILITÀ |
|---|---|
| Lek | |

L'importo degli assegni bancari, assegni circolari, vaglia o altri titoli similari consegnati alla Banca per il versamento in conto e accreditato salvo buon fine e non è disponibile prima che la Banca ne abbia effettuato l'incasso. Gli assegni bancari tratti sulla stessa Dipendenza o su altre Dipendenze della Banca sono accolti con riserva di verifica e salvo buon fine. Si applicano in ogni caso le condizioni che regolano presso la Banca Italo Albanese, i servizi d'incasso e di accettazione di effetti, documenti ed assegni. Si esonera la Banca Italo Albanese da responsabilità in merito all'eventuale mancata levata del protesto (ovvero constatazione equivalente) in tempo utile dei titoli che presentano termini brucianti.

FIRMA

Mod 10 c (6/95)

**BANCA ITALO ALBANESE**
**BANKA ITALO SHQIPTARE**

JOINT VENTURE UNIVERSAL BANK BETWEEN
BANCA DI ROMA-NATIONAL COMMERCIAL BANK OF ALBANIA
EUROPEAN BANK FOR RECONSTRUCTION AND DEVELOPMENT

Tirana li 16/04/1998

Spett.le
SUFA SH.P.K
TIRANA
Albania

Oggetto: C/C N.806414 intestato a SUFA SHPK

Con la presente attestiamo che la ditta SUFA SHPK ha un conto corrente in essere presso di noi. ed alla data odierna presenta un saldo apparente di LEK 100.000 (centomila ). quale versamento del capitale sociale.

Distinti saluti.

BANCA ITALO ALBANESE

BANCA ITALO ALBANESE
TIRANA

E Nderuara

SUFA SHPK
TIRANA
ALBANIA

Lenda: Llogaria rrjedhese 806414 ne emer te SUFA SHPK

Me ane te kesaj letre. Ju vertetojme se llogaria e lartpermendur gjendet e hapur prane Bankes tone dhe ne daten e sotme ka nje saldo te dukeshme prej LEK 100.000 ( njeqindmije ). si derdhje e kapitalit shoqeror.

Pershendetje.

Banka Italo Shqiptare

BANCA ITALO ALBANESE
TIRANA

ADDRESS RRUGA E BARRIKADAVE TIRANE TEL.(+355 42) 33966, FAX:(+355 42) 35701.TELEX (0604) 2157 IABANK AB

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

**KERKUESIT**: **QATIP SUFA** , I biri I Mexhitit, I dtl. 1954, me banim ne Damjan Vaqar, me shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.
**BEZAT SUFA ,** I biri I Mexhitit, I dtl. 1963, me banim ne Damjan Vaqar, me shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

**OBJEKTI :** Kerkojme regjistrimin si person juridik te shoqerise "SUFA" Shpk

**GJYKATES SE RRETHIT**
**T I R A N E**

Ne ortaket e shoqerise "SUFA" Shpk, Qatip Sufa dhe Bezat` Sufa ne perputhje me legjislacionin ne fuqi kemi krijuar me kontraten e dates _____1998, nje shoqeri te perbashket me shoqeri te kufizuar .

Emertimi I shoqerise eshte "SUFA" SHPK
Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke.
Selia e shoqerise eshte ne Damjan Vaqar , rrethit Tirane
Kohezgjatja mbi 10 vjet .
Administrator I shoqerise eshtee Qatip Sufa .

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte : Perpunim dhe tregtim te rrenjes se shqopes dhe marese, si dhe mbareshtimine pyjeve , pyllezime, permiresime pyjore , sistemime malore, shfrytezimin e pyjeve , rruget pyjore , mbareshtimin e flores spontane mjekesore e tanifere , mbareshtimin e faunes dhe gjuetine sportive e turistike , mbrojtjen nga semundjet , demtuesit dhe zjarret , mbareshtimin e kullotave dhe livadheve , ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe, tregtimin me shumice dhe me pakice I mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, fruta perime, pajisje elektrike ,elektroshtepiake, mallra te te gjitha llojeve, materiale dhe pajisje te ketyre mallrave industriale, prodhimi dhe tregtimi I pjeseve te tyre te kembimit,etj., eksport importin e te gjitha mallrave e materialeve .

Sa siper I kerkojme kesaj gjykate qe ne baze te legjislacionit ne fuqi te regjistroje shoqerine "SUFA" Shpk, si person juridik.

**K E R K U E S I T**
**Qatip Sufa**
**Bezat Sufa**

Qatip Sufa Bezat Sufa

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NR.**1521 **REP.**

**V E R T E T I M]**

Ne Tirane, sot me daten 17.04.1998, para meje noteres publike Miranda Xhemalce, notere e Dhomes se Notereve Tirane,me seli ne Rrugam "Zhan D'ark"u paraqiten personalish Qatip Sufa, I biri I Mexhitit, I dtl.1954, me banim Damjan Vaqar me pasaporten nr. AZ 372945 , dhe e Bezat Sufa, I biri I Mexhitit, I dtl. 1963, me pasaporten nr.0820243 , te dy madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, te cilet deklaruan se sa siper eshte nje kerkese per regjistrim te shoqerise "SUFA" SHPK, e perpiluar jashte kesaj zyre dhe e nenshkrojten ne prezence te noteres. Une noterja e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E

MIRANDA XHEMALCE
N O T E R E
TEL 262 84
TIRANE

# PROCES-VERBAL

I mbjatur sot me daten 22.07.2005, lidhur me zhvillimin e mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese te Shoqerise "Sufa"Sh.p.k.
Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme e Shoqerise mbahet me daten 22.07.2005,prane zyrave te shoqerise,sipas njoftimit te bere nga administratori i Shoqerise,me rend dite per miratimin e raportit te ekspertit per zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004.
Ne mbledhje moren pjese ortaket Qatip Sufa dhe Bezat Sufa.
Mbledhja eshte thirrur nga administratori z.Qatip Sufa.
Ne mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga eksperti si dhe dokumentacioni bashkangjitur ketij raporti per zmadhimin e kapitalit themeltar pa ndryshuar vleren nominale te nje pjese, por duke rritur numrin e pjeseve te kapitalit te shoqerise, si dhe .
Ortaket u shprehen qe zmadhimi I kapitalit themeltar do te jete gjithsej ne shumen prej 7.448.000 leke I cili do te jete nga fitimet e realizuara si dhe rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004. Nga shtesa e kapitalit eshte rritur dhe numri i pjeseve prej 7.448 pjese me vleren nominale egzistuese prej 1.000 leke sipas raportit te ekspertit per vleresimin e kontributeve ne formen e fitimeve te ortakeve ne shoqeri.

Ne mbledhje u vendos qe Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise se bashku me shtesen e kapitalit nga kontributet (fitimet) eshte prej 7.548.000leke,(shtatemiljon-epeseqintedyzetetetemijeleke), (kapitali themeltar ishte 100.000 leke dhe behet 7.548.000 leke).
Kapitali zoterohet nga ortaket sipas perqindjeve te pjesemarrjes si me poshte:
1-z.Qati Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke,
2-z.Bezat Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke.

Vendimi qe mori Asambleja e jashtezakonshme e Shoqerise u votua nga ortaket.

Tirane,me 22.07.2005

**DREJTUESI**

**Qatip SUFA**

# RAPORT
# PER VLERESIMIN E ZMADHIMITT TE KAPITALIT TE SHOQERISE "SUFA"SH.P.K.

Ne zbatim te Vendimit date 28.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "Sufa"Sh.p.k., "Per zmadhimin e kapitalit te shoqerise" kam pranuar misionin per kryerjen e vleresimit te madhesise se kapitalit te shoqerise qe do te zmadhohet nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara nga shoqeria "Sufa"Sh.p.k. deri me 31.12.2004.

Per verifikimin dhe vertetimin e dokumentacionit te vleresimit te fitimeve (kontributeve) per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise "Sufa"Sh.p.k. realizohet nga zj.Leze Abazi.

Per realizimin e vleresimit te ketij kapitali (zmadhim kapitali) jam mbështetur ne aktet ligjore e nenligjore perkatese, në dokumentacionet qe disiponte drejtimi i shoqerise, si dhe në dokumentacionet e tjera dhe pikerisht:

1-Ne Bilancet Kontabel te viteve ku jane percaktuar dhe treguesit ekonomiko-financiare.

2-Ne Vendimin e dates 28.06.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "Sufa" sh.p.k. per zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara e rezervat e krijuara deri me 31.12.2004.

3.Ne proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme te Shoqerise "Sufa"Sh.p.k.

4-Ne Vendimin Nr.19264, korrik 2005 I Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, per miratimin e ekspertes Leze Abazi per hartimin e raportit te vleresimit te kapitalit qe do te shtohet nga fitimet e rezervat.

5-Ligji nr 7661 datë 19.01.93 "Per Kontabilitetin" dhe Plani Kontabel I Pergjithshem i Shqiperise.

6-Ligji nr. 7638 i dates 19.11.1992 "Per shoqeritë tregtare» .




7-Statuti I shoqerise "Sufa"sh.p.k.

8-Ligji Nr.8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te ardhurat".

P556 27/07/05

Dokumentacioni baze qe mu paraqit nga drejtimi I shoqerise"Sufa" sh.p.k. verteton egzistencen, pronesinë të kapitalit qe zotërohet nga ortaket, që shprehet dhe në zbatimin e procedurave te sakta per pregatitjen e ketij dokumentacioni per zmadhimin e kapitalit.

**Të dhëna per Shoqerinë "SUFA"Sh.p.k. ortakët dhe kapitalin e saj**

"Sufa" është Shoqeri Me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar dhe e regjistruar si person juridik i formës SH.P.K. me Vendimin nr.19264,date 17.04.1998 të gjykatës së rrethit të Tiranës. Selia e saj ndodhet në Vaqar Tirane
Kapitali ne momentin e krijimit te shoqerise ishte prej 100 mije leke dhe zoterohej nga dy ortake me pjesemarrje secili nga 50%.
Shoqeria drejtohet nga administratori z.Qatip Sufa.
Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ne fushen e tregtise import-eksport.
Shoqeria fitimet e realizuara nga ushtrimi I aktivitetit per cdo viti financiar I ka riinvestuar ne shoqeri, pra nuk i ka shperndare.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se drejtimi i shoqerise vendimet e asamblese nuk jane depozituar ne gjykate, keshtu qe shtesa e kapitalit do te jete per fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2004.
Me Vendimin e dates 28.06.2005 kërkohet zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë "Sufa" sh.p.k. nga kontributet e ortakut te vetem si rezultat I fitimeve te realizuara e te pa shperndara ne forme dividenti deri me 31.12.2004, si dhe rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004, kjo rritje kapitali do te behet duke rritur numrin e pjeseve.
Per cdo vit financiar shoqeria hartonte bilanc ku pasqyroheshin gjendjet e te gjitha llogarive e pasurive qe dispononte shoqeria..

**Përbërja e zmadhimit të kapitalit të shoqerisë .**

***1 -Mbështetja ligjore per zmadhimin e kapitalit***

a) Ligji nr.7638 I dates 19.11.1992 ''Per shoqerite tregtare'',

b) Ligji 7661 date 19.01.1993 ''Per Kontabilitetin'' dhe Plani Kontabel I Pergjithshem I Shqiperise

c) Statuti I shoqerise "Sufa" Sh.p.k.

d) Vendimi I dates 28.06.2005 i Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "Sufa"Sh.p.k.

Aktivet e qëndrueshme të trupezuara deri me 31.12.2004 janë inventarizuar nga komisioni I ngritur per kete qellim ne fund te vitit dhe vlefta e tyre eshte gjithsej prej 740.000 leke.
-Te tjera ne shfrytezim prej 10.961.729 leke.

Aktivet qarkulluese ne fund te vitit 2004 jane ne vlefte prej 7.079.444 leke si vijon:

-Gjendja e kerkesave prej 4.316.878 leke qe perbejne te drejtat e shoqerise ndaj te treteve.

-Gjendja e likuiditeteve prej 2.762.566 leke qe perben gjendjen e parave ne fund te vitit ne arke prej 2.684.795 leke, gjendja e parave ne llogarine bankare prej 77.771 leke.

**Fitimet e realizuara dhe dokumentacioni baze.**

Sipas dokumentave baze, pra te bilanceve kontabel te ushtrimeve deri me 2004 per shoqerine "Sufa" Sh.p.k. dhe pasqyres se humbjeve e fitimeve, rezultojne keta tregues.

Ne vitin 1999 shoqeria "Sufa"ka realizuar nje fitim prej 683.381 leke.

Ne vitin 2000 shoqeria "Sufa" Sh.p.k ka realizuar nje fitim prej 681.658 leke, Shuma e fitimeve te mbartura ne vitin 2000 nga fitimet e viteve te mepareshme eshte prej 683.381 leke, si dhe shuma e rezervave te krijuara gjithsej nga fitimet e vitit ushtrimor eshte prej 34.082 leke (shuma e fitimit te vitit 2000 prej 681.658 leke – shumen e fitimit te pasqyruar ne llogarine e fitimit ushtrimor 2000 prej 647.576 leke).

Ne vitin 2001 shoqeria "Sufa" Sh.p.k ka realizuar nje fitim prej 1.179.522 leke, Shuma e fitimeve te mbartura ne vitin 2001 nga fitimet e viteve te mepareshme eshte prej 1.330.957 leke, si dhe shuma e rezervave te krijuara gjithsej nga fitimet e vitit ushtrimor eshte prej 58.976 leke (shuma e fitimit te vitit 2001 prej 1.179.522 leke – shumen e fitimit te pasqyruar ne llogarine e fitimit ushtrimor 2001 prej 1.120.546 leke), pra shuma e rezervave gjithsej eshte prej 93.058 leke (rezerva te mbartura te krijuara nga fitimet e viteve te meparshme prej 34.082 leke + rezerva te krijuara ne vitin ushtrimor nga fitimet e vitit 2001 prej 58.976 leke) .

Ne vitin 2002 shoqeria "Sufa" Sh.p.k ka realizuar nje fitim prej 1.341.155 leke, Shuma e fitimeve te mbartura ne vitin 2002 nga fitimet e viteve te mepareshme

eshte prej 2.451.503 leke, si dhe shuma e rezervave te mbartura gjithsej nga fitimet e viteve te meparshme eshte gjithsej prej 93.058 leke.

Ne vitin 2003 shoqeria "Sufa" Sh.p.k ka realizuar nje fitim prej 1.540.770 leke, Shuma e fitimeve te mbartura ne vitin 2003 nga fitimet e viteve te mepareshme eshte prej 3.792.658 leke, si dhe shuma e rezervave te mbartura gjithsej nga fitimet e viteve te meparshme eshte gjithsej prej 93.058 leke.

Ne vitin 2004 shoqeria "Sufa" Sh.p.k ka realizuar nje fitim prej 2.022.166 leke, Shuma e fitimeve te mbartura ne vitin 2004 nga fitimet e viteve te mepareshme se bashku me shumen e rezervave eshte prej 5.333.428 leke, si dhe shuma e rezervave te mbartura gjithsej nga fitimet e viteve te meparshme eshte gjithsej prej 93.058 leke.

Duke qene se ne bilancin e llogarive vjetore te mbyllur me 31.12.2004 shuma e fitimeve te realizuara te mbartura eshte prej 5.333.428 leke, shuma e fitimeve te realizuara gjate ushtrimit 2004 eshte prej 2.022.166 leke, si dhe shuma e rezervave te krijuara eshte prej 93.058 leke dhe shtesa e kapitalit eshte prej 7.448.652. Sic del dhe shtesa e kapitalit do te jete per shumen e ketyre elementeve prej 7.448.652 leke (fitime te mbartura prej 5.333.428.44 leke + fitimin e vitit 2004 prej 2.022.165.81 leke + rezervat e krijuara prej 93.058 leke = 7.448.652 leke). Ne shtese te kapitalit do te perfshihet shuma prej **7.448.000** leke, qe ka kunderparti reale (active te qendrueshme e active qarkulluese) ne aktivin e shoqerise "Sufa" sh.p.k. sipas spjegimeve te mesiperme.
Treguesit e pasqyruar ne bilancin e ushtrimit 2004 japin nje pamje te sinqerte e besnike te pasurise se shoqerise "Sufa" sh.p.k.

Duke shtuar kapitalin eshte rritur dhe numri I pjeseve, ndersa vlera e nje pjese egzistuese nuk ka ndryshuar. Numri I pjeseve eshte rritur prej 7.448 me vlere secila prej 1.000 leke.

Numri I pjeseve te rritura eshte prej 7.448 pjese.

Llogaritja eshte bere sipas formulas:

Shuma e kapitalit themeltar : vleren nominale per nje pjese.

| | | |
|---|---|---|
| Shtesa e kapitalit themeltar te rritur | = | 7.448.000 leke. |
| Vlera nominale e nje pjese | = | 1.000 leke. |
| Shtesa e kapitalit prej 7.448.000 leke : 1.000 leke | = | 7.448 pjese. |

Dokumentacioni origjinal justifikues I kapitalit themeltar ne momentin e krijimit si dhe per shtimin e kapitalit qendron prane shoqerise"Sufa"Sh.p.k.

Ne perfundim te aktit te ekspertimit te shtimit(zmadhimit) te kapitalit rezultoi se ky shtim (zmadhim) kapitali është bere me perfshirje te fitimeve te realizuara dhe rezervave te krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2004 prej 7.448.652 leke sipas spjegimeve te mesiperme .
Vlefta prej 7.448.000 leke do te kaloje ne kredi te llogarise kapitali I nenshkruar, dhe diferenca prej 652 leke ( 7.448.652 leke – 7.448.000 leke ) do te kaloje ne mbartje te fitimeve te viteve te meparshme pasi nuk ploteson vleften e nje pjese te kapitalit, si dhe shuma prej 7.448.000 leke do te kaloje ne debi te fitimeve te ushtrimit si dhe ne debi te fitimeve te mbartura e rezervave.

Nga analizimi, kontrolli dhe vertetimi I kujdesshem I bere dokumentacionit qe u paraqit, si dhe verifikimit ne vend te kontributeve ne natyre dhe pregatitjes se dokumentacionit sipas kerkesave te Statutit te Shoqerise dhe neneve 61, 63, te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe Vendimit te dates 28.06.2005 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise "Sufa" Sh.p.k. bashkangjitur ketij akti(raporti) konkludoj se vlefta e kapitalit themeltar qe do ti shtohet ne formen e shtimit (zmadhimit) te kapitalit nga fitimet e rezervat eshte prej 7.448.000 leke (shtatemiljonekaterqintedyzetetetemijeleke).

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise se bashku me shtesen e kapitalit nga kontributet(fitimet e rezervat deri me 31.12.2004) eshte prej 7.548.000 leke (shtatemiljonepeseqintedyzetetetemijeleke), (kapitali themeltar ishte 100.000 leke behet 7.548.000 leke).
Kapitali zoterohet nga ortaket sipas perqindjeve te pjesemarrjes nga:
1-z.Qati Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke,
2-z.Bezat Sufa me pjesemarrje 50 % ose 3.774.000 leke.

**Kapitali themeltar I shoqerise "Sufa"sh.p.k. behet prej 7.548.000 (shtatemiljonepeseqintedyzetetetemijeleke).**

Tirane , me 22.07. 2005

**EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR**

**Leze ABAZI**

Eksperte Kontabel e Autorizuar LEZE ABAZI